

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Me objekt:“ Ruajtja e objekteve dhe e ambienteve rrethuese te Sh.A UK Vlore me roje private te sigurisë fizike (12 muaj)

Fondi Limit : 36,887,921 (tridhjetë e gjashtëmiljon e teteqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nenteqind e njetë e njemije)Lekë Pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi Limit : 36,887,921 (tridhjetë e gjashtëmiljon e teteqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nenteqind e njetë e njemije)Lekë Pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e AK ,Vlorë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1.1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte

Argumentimi:Bazuar mbi Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” Neni 83 “Sigurimi i ofertes”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Formulari përmbledhës I vetdeklarimit sipas VKM 285 i dates 19.05.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, dhe Ligji Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”.

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.2. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Per operatorin e pajisur me certifikate 1.3 A

a) **Licensë e nenkategorise 1.3.A për shoqërinë**, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit të "Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike", nënkategoria 1.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike", lëshuar nga QKL;

b) **Çertifikatë e drejtuesit teknik** për ushtrim të aktivitetit konform Ligjit nr.75/2014, date 10.07.2014. Kjo certifikate duhet të jete lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për kategorinë "1.3.A"

c) **Çertifikatë për nënkategorinë 1.3.A për titullar të subjektit**, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A; Model-1 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

d) **Çertifikata për punonjës shërbimi** në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 44 (**dyzete e katër**) punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Vlorë, (Certifikatat e punonjësve të jene brenda afateve ligjore).

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne Ligjin Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 83, Pika 2, germa b, ku citohet se : " duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente."

3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

3.1 Operatori ofertues duhet të paraqese Vertetim nga Administrata Tatimore mbi xhiron mesatare vjetore si dhe pasqyrat financiare per tre vitet e fundit 2019-2020-2021 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiro vjetore duhet të jetë, në një vlerë jo më e vogël se 40% e vleres se fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 43 " Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", pika 2, shkronja C, ku citohet se: " Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Dhe

VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 43 ” Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, ku citohet: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. ”

3.2 Operatori ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a). Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht dyzet e katër punonjës të siguruar në muaj, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet në VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 41 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 4, shkronja C, ku citohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”

4. Kapaciteti teknik:

4.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast, vlera e kërkuar është në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate, që prokurohet që është realizuar gjatë tre viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Per këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtme:

a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të shërbimeve të realizuara ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

ose

b - Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", pika 3, ku citohet :

"Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. "

4.2 Operatori ofertues duhet të paraqesë Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të **ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"**, me zonë mbulimi zona apo zonat ku kerkohet sherbimi.

4.3 Vertetim Performance Model -21 nga Drejtoria Vendore e Policise se Qarkut Vlore, leshuar ne vitin 2022 ku te jepen te dhenat si me poshte:

- Te vertetoje ekzistencen e qendres se kontrollit sherbimi (24-oresh) Konform Ligjit 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike".
- Numrin e punonjesve te certifikuar (kategoria 1.3 A), minimumi 44 (dyzete e kater) punonjes sherbimi roje.
- Nje pergjegjes sherbimi.
- Numrin e lejeve te armeve.
- Te kete grup te gatshem

4.4 Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun Vlore ku kerkohet sherbimi sipas **Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem "Per Funkionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike"** ku ushtron aktivitetin SHPSF.

4.5 Ofertuesi per te permbushur kontraten duhet te kete ne perdorim (ose te marr me qera) te pakten 10 radio komunikimi. Per kete ofertuesi te paraqese nje deklarate per sasine, llojin dhe numrin e radiove apo paisjeve te komunikimit qe ka ne perdorim.

Argumentimi:

4.7 Ofertuesi duhet të disponojë së paku nga 6 **automjete** për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qira. Për këtë operatori ekonomik duhet:

- Te plotesoje formularin e vetdeklarimit ku te citoje disponibilitetin e 6 automjeteve.
- Leje e Qarkullimit dhe taksat e automjetit në pronësi të shoqërisë.

Në rastin kur automjeti është marrë me qira, Leja e Qarkullimit duhet të shoqerohet edhe me Kontratën noteriale të marrjes me qira, ku të jetë përcaktuar afati dhe qellimi i marrjes me qira.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet ne VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", Pika 4, germa ç, ku citohet:

"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën".

4.6 Ofertuesi duhet të disponojë katërmbëdhjetë armë të gjata për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shitjes së armëve, dhe faturat tatimore të shitjes së armëve.

Arguemntin . Ne baze të vendimit

Argumentimi: Formulari përmbledhës I vetdeklarimit sipas VKM 285 i datës 19.05.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, Neni 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit", dhe Ligji Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" Neni 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit", dhe

VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", Pika 4, germa ç, ku citohet:

"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën".

4.8 Operatori duhet të paraqesë analizen e kostos ligjore të ofertës.

V.O Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që të verifikojë në terren në çdo kohë, gjatë shqyrtimit të ofertave dhe pas lidhjes së kontratës, realizimin e kriterëve të mesiperme. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që gjatë shqyrtimit të ofertave të kërkojë shpjegime apo sqarime për çështje të caktuara në funksion të realizimit të prokurimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit